



# USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 33 (827731)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 13 Gusht 2021

Zjarret në vend, Ambasadorja Kim në Pashaliman: Çastet kur miqtë dhe aleatët qëndrojnë së bashku



## SHBA në krah të Shqipërisë

Situata problematike e zjarreve për shkak të temperaturave të larta që kanë përfshirë vendin tonë, ka bërë që ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim të zbresë në Pashaliman, Vlorë. Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, Yuri Kim në datën 10 gusht 2021, së bashku me ekspertë

nga USAID dhe përfaqësues të lartë nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, zhvilluan një takim në Pashaliman, me ministrin e Mbrojtjes, Niko Peleshi, drejtorin e Përgjithshëm të AKMC, Haki Çako dhe titullarë të tjerë të lartë nga strukturat vendore. Në një njoftim për mediet, Ambasada Amerikane në Tiranë theksoi... >>> faqe 2

MBËRRIJNË 3 HELIKOPTERË NGA HOLANDA E ÇEKIA

Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së ndihmë për shuarjen e zjarreve



>>> faqe 5

## S'ka më vatra zjarri në gadishullin e Karaburunit Ministri Peleshi: Situatë më e qetë zjarresh në vend, u shuan 175 vatra

Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë e madhe në punën për shuarjen e zjarreve ishte edhe mbështetja me pajisje nga SHBA >>> faqe 3



## Forcat përqendrohen në Kalimash

### Largohet rreziku i flakëve nga Parku Kombëtar i Llogarasë

Disa vatra zjarri vijojnë të jenë shqetësuese ende, pavarësisht punës dhe ndërhyrjes së forcave operacionale në të gjithë territorin e vendit", njoftoi Ministria e Mbrojtjes në datën 09 gusht 2021, ora 18.00. "Tashmë është larguar rreziku i flakëve në drejtim të Parkut Kombëtar të Llogarasë, por operacioni vijon për të normalizuar situatën. Forcat janë përqendruar në zonën e tunelit të Kalimashit, ku si pasojë...



>>> faqe 4

## Viti i ri Akademik 2021-2022

### Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve

Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve për Vitin Akademik 2021-2022 raundi i parë do të jenë 6 - 13 gusht 2021, nga ora 9.00-16.00 (aplikantët para se të bëjnë pagesën duhet të verifikojnë emrin në listat e afishuara në AFA dhe në portalin ualbania.al). Shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurrim në AFA - FMS do... >>> faqe 8



## Mjedisi i sotëm i sigurisë, rezistenca dhe neni 3

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 10

TRUPAT E FSK-SË NË SHQIPËRI PËR SHUARJEN E ZJARREVE

### Ministri Mehaj: Së bashku jemi më të fortë në kohë të vështira

faqe 2

### ANALIZË

### Agresioni ushtarak gusht 1949: Provokacion apo agresion ushtarak?

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

faqe 9

Situata problematike e zjarreve për shkak të temperaturave të larta që kanë përfshirë vendin tonë, ka bërë që ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim të zbresë në Pashaliman, Vlorë.

Ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, Yuri Kim në datën 10 gusht 2021, së bashku me ekspertë nga USAID dhe përfaqësues të lartë nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë, zhvilluan një takim në Pashaliman, me ministrin e Mbrojtjes, Niko Peleshi, drejtorin e Përgjithshëm të AKMC, Haki Çako dhe titullarë të tjerë të lartë nga strukturat vendore.

Në një njoftim për mediet, Ambasada Amerikane në Tiranë theksoi se ambasadorja Kim, në emër të popullit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shprehu trishtimin e thellë për dëmin e shkaktuar nga zjarret në Shqipëri.

“Mendimet tona shkojnë për të gjithë shqiptarët gjatë kësaj kohe të vështirë, veçanërisht me ata jetët e të cilëve janë prekur nga shkatërrimi. Ne i jemi mirënjohës personelit ushtarak dhe zjarrfikësve për aktet e tyre heroike për të luftuar zjarret dhe ndihmuar në parandalimin e humbjeve të mëtejshme të jetëve dhe pronës. Gjithashtu do të doja të falënderoja Ministrin e Mbrojtjes Peleshi, Shefin e Shtabit Begaj dhe Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Çako për përpjekjet e tyre në udhëheqjen e përgjigjes ndaj këtyre zjarreve”, tha ambasadorja Kim.

“Unë sot jam në rajonin e Vlorës për të takuar ekipin tonë amerikan të ekspertëve nga Byroja për Ndihmë Humanitare e USAID, të cilët erdhën në Shqipëri për të ndihmuar me përpjekjet e koordinimit dhe përgjigjes. Unë jam mirënjohëse për përgjigjen e tyre të shpejtë ndaj thirrjes për ndihmë. Ata tashmë kanë filluar të trajtojnë sfiadat, duke punuar së bashku me partnerët tanë shqiptarë. Këto përpjekje të përbashkëta dhe bashkëpunimi midis vendeve tona është ajo çka aleatët bëjnë për njëri-tjetrin në kohë nevojë. Këto janë çastet kur miqtë dhe aleatët qëndrojnë së bashku për të përballuar këto sfida të vështira”, vijoi Kim.

“Unë jam gjithashtu shumë e kënaqur që planifikimi i mëparshëm i emergjencës midis vendeve tona po ndihmon me këto përpjekje, veçanërisht dhurimet e pajisjeve të zjarrfikësve nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 2019. Pajisjet e zjarrfikësve, të tilla si kovat “Bambi” të përdorura nga helikopterët, tani po përdoren për të shpëtuar jetë”, tha ajo. “Më lejoni ta them sërish, populli amerikan është në krahun tuaj – dhe do të jetë gjithmonë në krahun tuaj – gjatë kohëve të vështira”, përfundoi ambasadorja Kim. “SHBA është në krah të Shqipërisë edhe në këtë situatë të vështirë me zjarret, që ka prekur vende të ndryshme të botës”, tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi. “Prita sot, në bazën e Pashalimanit ambasadorin Yuri Kim, me të cilën ndamë shqetësimin për gjendjen. E falenderova ambasadorin për ndihmën që SHBA ka dhënë në pajisje dhe jo vetëm, për emergjencat civile. Mirënjohje për kontributin e ekipit amerikan të ekspertëve nga Byroja për Ndihmë Humanitare e USAID, të cilët kanë ardhur në Shqipëri për të ndihmuar me përpjekjet e koordinimit dhe përgjigjes ndaj flakëve”, shkroi ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.



# SHBA në krah të Shqipërisë

Zjarret në vend, Ambasadorja Kim në Pashaliman: Çastet kur miqtë dhe aleatët qëndrojnë së bashku



TRUPAT E FSK-SË NË SHQIPËRI PËR SHUARJEN E ZJARREVE

## Ministri Mehaj: Së bashku jemi më të fortë në kohë të vështira

Një kontingjent i FSK-së u nis për në Republikën e Shqipërisë, drejt zonave të prekura nga përhapja e zjarreve, për t’iu bashkangjitur forcave reaguese vendore për angazhim në operacion për shuarjen dhe vënien në kontroll të zjarreve. Vendimi për zbatim të kontingjentit të FSK-së në operacion për shuarjen e zjarreve në Republikën e Shqipërisë, ka ardhur pas kërkesës së autoriteteve shqiptare për mbështetje drejtuar ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj.

Me këtë rast, ministri Mehaj ka siguruar homologun tij, ministrin Niko Peleshi, se vullneti i tij për zbatim të kontingjentit të FSK-së në operacion për shuarjen e zjarreve, do të përkrahët fuqishëm nga Qeveria e Republikës, me në krye kryeministrin Albin Kurti dhe Presidentin e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Kontingjenti i FSK-së me arritjen në zonën e operacionit i është bashkëngjitur efektivave reagues të institucioneve të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të Shtabit Emergjent të Kukësit në datën 9 gusht 2021.

“I nisëm trupat tona të FSK-së në mbështetje të vëllezëve e motrave tona në Republikën e Shq-



ipërisë. Prej fillimit të shpërthimit të zjarreve, krahas operacioneve tona në vend, kam ofruar mbështetjen e plotë me kapacitetet tona në dispozicion për mbështetje të vëllezëve dhe motrave tona në Republikën e Shq-

ipërisë.”, shkroi ministri Armend Mehaj në profilin e tij në rrjetin social. “Së bashku jemi më të fortë në kohë të vështira”. Shërbimeve zjarrfikëse në Kukës, iu bashkuan 100 forca nga Kosova.

# Nuk ka më vatra zjarri në gadishullin e Karaburunit

## Ministri Peleshi: Situatë më e qetë zjarresh në vend, u shuan 175 vatra

*Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë e madhe në punën për shuarjen e zjarreve ishte edhe mbështetja me pajisje nga SHBA*

**P**as dy javësh në betejë me zjarret në të gjithë territorin e Shqipërisë, situata në datën 11 gusht 2021, paraqitet më e qetë. Në të gjithë vendin janë shuar 175 vatra, ndërsa mbeten aktive 9 vatra. Në këto operacione janë angazhuar rreth 3.000 efektivë të Forcave të Armatosura, rreth 150 mjete të FA, rreth 300 forca policore, rreth 1800 forca zjarrfikëse, mbi 370 mjete të MZSH, 20 ambulanca, mbi 1.000 punonjës bashkiakë, mbi 300 punonjës të shërbimit pyjor, 101 punonjës të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura dhe 822 forca vullnetare.

Ndërhyrja nga ajri u krye përmes ekuipazheve të 7 helikopterëve të Shqipërisë, Holandës dhe Çekisë. Një ndihmë e madhe në punën për shuarjen e zjarreve ishte edhe mbështetja me pajisje nga SHBA.

Aktualisht nuk ka më vatra zjarri në gadishullin e Karaburunit, por puna po vijon në Dukat të Ri, nga toka dhe nga ajri për të normalizuar tërësisht situatën për të shmangur çdo mundësi riaktivizimi.

Më e qetë paraqitet situata edhe në Mirditë, ku po vijon puna për stabilizimin e flakëve në fshatin Thirrë. Nën kontroll po mbahen vatrat në fshatin Munellë dhe Domgjon. Po vijon puna nga toka dhe nga ajri për të izoluar vatrat e zjarrit në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi. Situata nuk paraqet më rrezik për tunelin e Kalimashit. Nën monitorim janë disa vatra zjarri në vendin e quajtur Dragodi, në luginën e Valbonës në Tropojë, ku dyshohet zjarrvënien e qëllimshme. Janë izoluar vatrat në drejtim të fshatit Patalej në Lezhë. Vijon puna për normalizimin e vatrës së riaktivizuar në zonën e mbrojtur të Guri i Nikës në Pogradec, ku nuk paraqitet rrezik për banesat. Janë drejt shuarjes



përfundimtare vatrat e zjarrit në Malin e Tomorrit dhe në fshatin Therepel në Skrapar. "Më në fund pas 2 javësh mundi dhe sakrificash, nuk ka më vatra zjarri në Karaburun. Qindra orë betejash, qindra trupa të Forcave të Armatosura e forcave zjarrfikëse, specialistë të zonave të mbrojtura dhe emergjencave civile

kanë punuar pa u lodhur për të shpëtuar Parkun Kombëtar të Llogarasë.", tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi. "Kjo stinë e nxehtë s'ka mbaruar por sot, në këtë moment frymëmarrjeje dua t'i falenderoj të gjithë ata që dhanë gjithçka në këto ditë të vështira. Të gjithë po bëjmë detyrën por disa heronj shkojnë



përtej detyrës. Prefekti Flamur Mamaj, komandantët që drejtuan operacionet e vështira Gëzimi, Pëllumbi, Idrizi, Arbeni, punonjësit e Agjencisë së Mbrojtjes Civile, punëtorët e palodhur të zonave të mbrojtura si Nexhipi, Ganiu e te tjerët që nuk i takova dot sepse ishin gjithë kohën në frontin e betejës me zjarret, pilotët

Juliani, Agimi, Ervini dhe Agroni, janë shqiptarë të rrallë që meritojnë respekt dhe mirënjohje. Nuk mund ta le mënjane çdo ushtar të thjeshtë që nuk ia mësova dot emrin por i pashë veprën. Sfidat vazhdon. Ne jemi të gatshëm në krah të komuniteteve lokale.", tha ministri i Mbrojtjes Peleshi.

### SITUATA E ZJARREVE NË VEND

## FA vijojnë punën me intensitet nga toka dhe nga ajri për shuarjen e zjarrit

**L**logaraja nuk rrezikohet dhe as fshati Dukat", tha në njoftimin e saj Ministria e Mbrojtjes në datën 10 gusht 2021 duke njoftuar mbi vatrat aktive në vend në orën 23.00.

**1) Qarku Vlorë:** Vatra e zjarrit, në gadishullin e Karaburunit dhe fshatin Dukat, njësi administrative Orikum, vijon akoma. Forcat vazhdojnë punën intensivisht. Situata është ende problematike në disa zona. Llogaraja nuk rrezikohet dhe as fshati Dukat. Nesër do të fillojnë punën forcat dhe dy mjete nga ajri.

**2) Qarku Lezhë:** Bashkia Mirditë, në fshatin Thirrë, njësi administrative Fan. Në këtë zonë ditën e sotme u përqendruan të gjitha forcat tokësore dhe nga ajri. Pjesa nga ana e tunelit është e normalizuar. Vijon monitorimi nga forcat gjatë natës. Nuk paraqet rrezik për banesat dhe tunelin.

**3) Qarku Lezhë:** Gjatë punës ditën e sotme vatrat e zjarrit në fshatin Munellë dhe Domgjon është bërë e mundur izolimi në pjesën nga ana e Domgjonit. Momentalisht vatra e zjarrit ka një shtrirje të madhe në terren të thyer dhe është i vështirë izolimi në tërësi i saj. Gjatë natës po monitorohet. Nuk ka akoma rrezik banesash.

**4) Qarku Lezhë:** Bashkia Lezhë, në fshatin Patalej, njësi administrative Kolsh, ditën e sotme forcat në terren punuan për të izoluar një pjesë që ka drejtim në rrugët e fshatrave. Gjatë natës po monitorohet. Situata mbetet problematike. Nuk ka akoma rrezik banesash.

**5) Qarku Kukës:** Vatra e zjarrit në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi, nga puna e kryer ditën e sotme si nga toka ashtu edhe nga ajri, situata vijon

të mbetet problematike në disa anë. Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë mundësuar izolimin e vatrës tek zona Qafa e Kumbullës, FA të Kosovës ka punuar nga ana e Lakut të Mollës, e cila vijon të jetë aktive me intensitet të lartë që është në kufi me Pukën. Edhe ana nga Laku i Qershivë vijon të mbetet problematike. Terreni ndërlikon punën e forcave nga toka si pasojë e pjerrësisë dhe zonës shkëmbore. Nuk ka akoma rrezik banesash. Vijon monitorimi i forcave gjatë natës.

**6) Qarku Korçë:** Bashkia Pogradec, njësi administrative Velca, në Guri i Nikës (zonë e mbrojtur) për shkak të erës së fortë u riaktivizua sërish zjarri i mëparshëm. Situata është e vështirë për ta përballuar pasi dhe largësia është shumë e madhe për të shkuar në vend. Situata monitorohet gjatë natës. Rrezik për banesat nuk ka.

**7) Qarku Durrës:** Vatër aktive në Fushë - Krujë në një depo që digjen goma të përdorura. Zjarri është vënë nën kontroll dhe është drejt shuarjes.

**8) Qarku Berat:** Bashkia Skrapar riaktivizimi i vatrës sipërfaqen me shkurre, në Malin e Tomorrit, në zo-

nën shkëmbore mbi Teqenë e Kulmakut, fshati Ujanik, po mbahet në monitorim, për të eliminuar rindezjet nga era dhe trunget e ndezur.

**9) Qarku Berat:** Bashkia Skrapar, në fshatin Therepel, njësi administrative Vendreshe. Situata doli jashtë kontrollit të forcave në terren, duke rrezikuar një zonë të banuar rreth 250 - 300 metra largësi. Menjëherë forcat kanë siguruar banorët dhe më pas kanë bërë të mundur vënien nën kontroll të situatës. Po monitorohet gjatë natës.

**10) Qarku Tiranë:** Bashkia Vorë, në fshatin Kuç, ka rënë një zjarr në një vend me shkurre ferra dhe mbeturina. Sipas informacioneve të para zjarri u raportua me përmasa të konsiderueshme, rrezikonte të futej në pyje. Forcat në terren bënë të mundur vënien nën kontroll. Situata po monitorohet. S'ka rrezik për banesat.

**11) Qarku Kukës:** Lugina e Valbonës, Tropojë në vendin e quajtur Dragobi, janë raportuar disa vatra zjarri në vende të ndryshme në të njëjtën kohë. Forcat janë duke punuar por si pasojë e terrenit është shumë e vështirë. Dyshohet zjarrvënien e qëllimshme. Po monitorohet gjatë natës.

**Situata e zjarreve në vend, 10 gusht 2021, ora 10.00**

Disa vatra zjarri në veri dhe në jug të vendit janë më problematike, aktualisht në të gjithë territorin. Po vijon me intensitet puna nga toka dhe nga ajri për shuarjen e zjarrit në Majën e Rrunës, njësi administrative Malzi. Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë mundësuar izolimin e vatrës tek zona Qafa e Kumbullës, ndërsa FSK e Kosovës janë përqendruar nga ana e Lakut të Mollës, e cila vijon të jetë aktive me intensitet të lartë, në pjesën që është në kufi me Pukën. Edhe pjesa e zonës nga Laku i Qershivë vijon të mbetet problematike. Terreni i pjerrët dhe shkëmbor ndërlikon punën e forcave nga toka, por nuk ka rrezik për banesat dhe situata po ndiqet nga strukturat e posaçme. Forcat nga toka dhe nga ajri janë përqendruar në fshatin Thirrë në Fan të Mirditës, ku po punohet për ndërprerje të përhapjes së flakëve dhe normalizimin e situatës. Pjesa në anë të tunelit është nën kontroll, ndërsa pjesa tjetër e malit vijon të ketë prani flakësh.

Vijon puna për shuarjen e zjarrit në fshatin Munellë dhe Domgjon. Forcat që janë në terren janë të përqendruara duke mbajtur të izoluar anën e fshatit Domg-

jon. Momentalisht vatra e zjarrit ka një shtrirje të madhe në terren të thyer dhe është i vështirë izolimi në tërësi i saj. Në terren po punojnë edhe efektivë të FA për ta mbajtur nën kontroll, në mënyrë që të mos kalojë në zonë të banuar.

Po ashtu problematike mbetet situata në vatrën mbi fshatin Dukat, e cila ishte stabilizuar më herët, por ka patur një rindezje të flakëve. Operacioni po vijon nga toka dhe nga ajri. Edhe në këtë zonë nuk ka rrezik banesash. Ka vijuar të jetë aktive një vatër në fshatin Patalej të Lezhës, ku forcat po punojnë për të izoluar një pjesë zjarri në drejtim të rrugëve të fshatit. Nuk ka rrezik për banesat edhe në këtë zonë. Zjarret në Krushovë, Gjonmadh dhe Leshnjë në bashkinë Korçë si dhe zjarri në zonën e quajtur Guri i Nikës në bashkinë Pogradec po mbahen nën kontroll nga forcat në terren dhe deri tani nuk paraqesin problem. Po mbahen nën monitorim vatra e riaktivizuar në sipërfaqen me shkurre në Malin e Tomorrit, në zonën shkëmbore mbi Teqenë e Kulmakut, fshati Ujanik, për të eliminuar rindezjet nga era dhe trunget e ndezur. Në qarqet Gjirokastrë, Fier, Dibër, Tiranë, Elbasan dhe Shkodër situata paraqitet pa probleme.



# Largohet rreziku i flakëve nga Parku Kombëtar i Llogarasë

*Forcat përqendrohen në zonën e tunelit të Kalimashit*



“Disa vatra zjarri vijojnë të jenë shqetësuese ende, pavarësisht punës dhe ndërhyrjes së forcave operacionale në të gjithë territorin e vendit”, njoftoi Ministria e Mbrojtjes në datën 09 gusht 2021, ora 18.00. “Tashmë është larguar rreziku i flakëve në drejtim të Parkut Kombëtar të Llogarasë, por operacioni vijon për të normalizuar situatën. Forcat janë përqendruar në zonën e tunelit të Kalimashit, ku si pasojë e erërave të forta dhe terrenit zjarri është përhapur drejt fshatit Shëmrri, ndërsa në vendin e quajtur Qafa e Kumbullës është bërë i mundur izolimi i flakëve. Në fshatin Trull, ku rrezikoheshin stane situata është nën kontroll. Për qetësimin e zjarrit do të bashkëpunohet edhe me forca ndihmë nga Kosova. Problematike vijon edhe situata në fshatin Thirrë, në Fan të Mirditës, ku zjarri është aktiv dhe rrezikon të afrohet në lagjen Gështenjë dhe në lagjen Karaq. Në terren po punojnë forcat e Armatosura, zjarrfikës e të shërbimit pyjor, për të bërë të mundur frenimin e vatrës, e cila duket mjaft e vështirë. Në fshatin Munellë si pasojë e erës së fortë zjarri është riaktivizuar dhe po zbret drejt fshatit Domgjon. Vatra aktive është edhe në fshatin Patalej, në Mirditë, ku zjarri vijon në sipërfaqe me shkurre”, tha Ministria e Mbrojtjes mbi situatën e zjarreve në vend, në 09 gusht 2021. “Situata është drejt përmirësimit në më shumë se gjysmën e sipërfaqes së prekur nga flakët në zonën e Krushovës në Voskopojë, ndërsa po punohen me intensitet në vatrën aktive në Gjonomadh, ku është prekur një sipërfaqe me ah dhe lajthi. Një tjetër vatrë është njoftuar në kodrat në afërsi të fshatit Leshnjë, po në Korçë, ku janë djegur rreth 1 ha shkurre, por flakët mbeten larg banesave. Forcat zjarrfikëse po punojnë në mënyrë që të mos preket masivi me pisha. Një vatrë zjarri është raportuar në vendin e quajtur Qafa e Tërkuzit në pjesën e Republikës të Malit të Zi, në afërsi të kufirit tonë, e cila po ndiqet me vëmendje.” Vatra të reja u raportuan edhe në fshatin Shtaj në Ishëm të Durrësit, pa rrezik për banesat si dhe një vatrë në zonën Guri i Nikës, pjesë e zonave të Mbrojtura në bashkinë e Pogradecit, e cila u monitorua nga punonjësit e Agjencisë së zonave të Mbrojtura. “Tashmë është drejt shuarjes zjarri në fshatin Corrush në Mallakastër, zjarri në fshatin Bogë në Shkodër, është izoluar vatra në Parkun e Tomorrit në Berat. Ndërsa ka një riaktivizim zjarri në Zogas të Skraparit, ku forcat po vijojnë punën për mbajtjen nën kontroll. U shua totalisht vatra e zjarrit në fshatin Lukan në Dibër. Në fshatin Hajdaraj, në Kavajë u raportua një zjarr në shkurre, i cili nga era mori përmasa të menjëhershme, duke rrezikuar banesat që ndodheshin në fshat. Por u sigurua në kohë evakuimi i banorëve dhe situata është nën kontroll. Në ndjekje është edhe një vatrë zjarri e raportuar në një zonë me pemë dushku, në fshatin Fanjë, në bashkinë Prrenjas, e cila ndodhet në terren të vështirë.” Prej ditësh forca të shumta operacionale, efektive të Forcave të Armatosura, zjarrfikës, punonjës të emergjencave civile e shërbimeve vendore po punojnë për shuarjen e zjarreve në zona të ndryshme të vendit, njoftoi Ministria e Mbrojtjes më herët në datën 09 gusht 2021. Pavarësisht punës së pandërprerë, disa

vatra zjarri janë ende problematike, u tha në njoftim. Vijoi të ishte aktiv vatra e zjarrit në fshatin Dukat i Ri, në gadishullin e Karaburunit, e cila paraqiti rrezikshmëri, pasi kishte përhapje në drejtim të Parkut Kombëtar të Llogarasë, ku prej orëve të para të mëngjesit rinisi operacioni edhe nga ajri. Vatra tjetër kritike ishte ajo në Majën e Rrunës, mbi tunelin e Kalimashit, ku vijoi puna për mbajtjen nën kontroll,

në mënyrë që flakët të mos kërcënonin banesat. Në fshatin Thirrë në Fan të Mirditës zjarri nuk paraqiti rrezik për banesa, ndërsa vijoi puna për shuarjen e tij. Zjarri në fshatin Munellë-Domgjon u izolua në njërin krah, por vijoi puna në krahun tjetër, ku ende kishte prani flakësh. Gjithashtu prej ditësh së mëparshme u vazhdua puna për shuarjen e flakëve në masivin me pisha në fshatin Krushovë,

në njësinë administrative Voskopojë. Prej orëve të para u shtuan forcat e ndërhyrjes nga FA, zjarrfikësit si dhe struktura të tjera të bashkisë Korçë e bashkive fqinje. Situata e vështirë zjarri ishte gjithashtu edhe në fshatin Patalej, njësinë administrative Kolsh, bashkia Mirditë, ku vazhdoi zjarri në shkurre, ndërsa u shtuan forcat operacionale. Nga ana tjetër në fshatin Corrush në

Mallakastër u izoluan dy vatra, por puna vijoi për izolimin e flakëve në tre vatra të tjera aktive, të cilat ishin në terren të vështirë. Në fshatin Bogë, njësinë administrative Shkrel ishte aktivizuar një vatrë zjarri mbrëmjen e një dite më parë, por që nuk paraqiti rrezik për banesat. Një vatrë zjarri u njoftua në Parkun e Tomorrit në lartësinë mbi 1500 m, por situata u ndoq nga forcat vendore.

## Forca Tokësore vijon operacionin e shuarjes së vatrave të zjarrit në vend

Efektivët të Forcës Tokësore u angazhuan për fikjen e zjarrit në zonën e Karaburunit, Gjirokastrë, si dhe në Fushë Arrëz, duke sfiduar terrenin dhe temperaturat ekstreme.

Me marrjen e sinjalit të emergjencës së rënies së zjarreve nga Qendra e Bashkuar Operacionale, Regjimenti i Operacioneve Speciale dhe të gjithë batalionet e këmbësorisë kanë dërguar trupat e gatshme në rajonet e prekura nga zjarri, si dhe kanë organizuar të gjithë efektivin me grupe duke bërë të mundur ndërrimin dhe rifreskimin e trupave në terren.

Në këtë operacion janë përfshirë të gjithë repartet e Forcës Tokësore të pajisura me bazë materiale të dedikuara për shuarjen e zjarreve. Ky operacion vazhdon pa ndërprerje, duke evakuuar dhe mbajtur nën vëzhgim zonat që rrezikohen nga përhapja e flakëve.

Angazhimi i Forcës Tokësore do të vazhdojë deri në fikjen e plotë të vatrave të zjarrit në Shqipëri.



## Mbërrijnë 3 helikopterë nga Holanda e Çekia

## Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së ndihmë për shuarjen e zjarreve

**K**anë mbërritur në aeroportin e Rinasit në datën 6 gusht 2021, 3 helikopterë, nga Holanda dhe Çekia, pjesë e mbështetjes që dy vendet po i japin Shqipërisë, në kuadër të aktivizimit të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, për shuarjen e zjarreve në territorin e Shqipërisë.

Mjetet u pritën në aeroportin "Nënë Tereza" nga zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako, përfaqësues të ambasadave përkatëse, shefi politik i Delegacionit të BE në Tiranë Alexis Hupin.

Zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici falënderoi në emër të qeverisë shqiptare dy vendet për ndihmën e dhënë në këto ditë të vështira, ndërsa njoftoi se puna e helikopterëve do të niste të nesërmen në mëngjes herët.

Drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile Haki Çako shprehu mirënjohjen për përgjigjen në kohë të shpejtë të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile Evropiane, duke vënë në dukje se situata ka qenë e rënduar veçanërisht në gadishullin e Karaburunit, pikërisht në kufi me Parkun Kombëtar të Llogarasë. Shefi politik i delegacionit të BE, Alexis Hupin tha se ndihma që vjen nga Bashkimi Evropian është shenjë e solidaritetit evropian: "Kjo është një shprehje e solidaritetit të



Bashkimit Evropian dhe duam t'i qëndrojmë në krah të Shqipërisë në këto momente. Jemi këtu për të mbrojtur jetët e njerëzve që po preken nga këto zjarre dhe gjithashtu bukuritë e natyrës shqiptare. Nesër fillon puna me helikopterin", - u shpreh z. Hupin.

Nga Çekia mbërriti helikopteri i parë, nga 3 që pritet t'i bashkohen flotës së ndihmës për shuarjen e flakëve. Bashkë me helikopterët,

pjesë e ndihmës janë edhe mbi 50 forca ushtarake të specializuara në fushën e Emergjencave Civile, të cilët do t'i bashkohen efektivëve shqiptarë që prej ditësh janë në përpjekje të pandërprera për shuarjen e flakëve në disa zona të Shqipërisë.

Bashkimi Evropian aktivizoi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile për t'u ardhur në ndihmë disa prej shteteve më të prekura nga zjarret si: Shqipëria, Italia, Greqia e Maqedonia e Veriut.



11 DITË BETEJË NGA TOKA DHE AJRI, SHUHEN 163 VATRA ZJARRI

## Ministria e Mbrojtjes: Ja si paraqitet situata në vend në datën 6 gusht 2021

**163** vatra zjarri janë shuar në të gjithë territorin e vendit, në një periudhë 11 ditore. Agjencia e Mbrojtjes Civile në 6 gusht 2021 ka bërë një bilanc të punës së kryer, nga efektivët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë shkuar në ndihmë të autoriteteve të pushtetit vendor, kur është kërkuar ndërhyrja e tyre. Zjarret e rëna në bashkinë Fier më datë 28 korrik 2021, në fshatin Kreshpan, Cakran dhe në vendgrumbullimin e mbeturinave në Fier janë shuar 3 ditë pas operacioneve pa pasur dëme në njerëz dhe banesa. Për 11 ditë është punuar nga toka dhe nga ajri në vatrën e zjarrit në gadishullin e Karaburunit. Kjo vatrë është e izoluar në pjesën më të madhe të tij. U shua në një kohë rekord zjarri i rënë më datë 30 korrik 2021, në vendin e quajtur Qafa e Hartës, në Ksamil, bashkia Sarandë, duke shmangur me sukses rrezikun që paraqitej për banesat aty pranë. Zjarri i rënë në Himarë, Livadh, u shua në kohë të shpejtë, duke mos i lënë flakët të kalojnë në zonën ku pushonin turistët. U realizua me sukses mbajtja jashtë rrezikut e banesave dhe



e banorëve nga zjarri që ra në fshatin Kutal, bashkia Përmet. Zjarret e rëna në fshatrat: Qestorat, Dhoksat, Arshi Lengo, Asim Zeneli, Krinë, Tranoshisht, Saraqinisht, në bashkinë Gjirokastrë u shuan përfundimisht, duke shpëtuar në kohë banorët dhe banesat, por fatkeqësisht vetëm me një humbje jete dhe një të lënduar. Janë shuar totalisht edhe zjarret në fshatrat Gjorm dhe Gumenicë, në qarkun Gjirokastrë. Këto vatra u shfaqën në mënyrë të menjëhershme dhe me drejtim të pakontrolluar si pasojë e erërave të forta. U arrit të mbrohej jeta e

banorëve që ishin të rrethuar nga flakët. Zjarri i rënë në bashkinë Kurbin më datë 01 gusht 2021, në njësinë administrative Mamurras, në një sipërfaqe me pyll pishe dhe lis, u shua në kohë duke shmangur rrezikun e banesave që ishin shumë pranë vatrave. Edhe flakët në qytetin Fushë - Arrëz, u menaxhuan pa kaluar tek banesat aty pranë. Është shuar tërësisht edhe vatra e zjarrit në Kalis të Kukësit, i cili rrezikoi edhe banesat e zones.

## Situatë me e qetë nga zjarret në vend, 2 vatra kritike, 8 nën monitorim

Pas gati dy javësh në "luftë" me zjarret, në datën 6 gusht u shënu dita më e qetë. Falë punës së bërë nga efektivët e Forcave të Armatosura, punonjës të Shërbimit Zjarrfikës, Emergjencave Civile pranë pushtetit vendor, është bërë e mundur shuarja e shumë vatrave agresive në zona të ndryshme të territorit të vendit.

Vetëm në 6 gusht, përmes koordinimit me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u shuan 15 vatra zjarri, por mbetën ende 10 vatra aktive. 2 prej tyre si Karaburuni dhe Maja e Rrunës janë vatra me intensitet më të lartë. Në majën e Rrunës, helikopteri ka bërë të mundur uljen e agresivitetit të flakëve dhe nuk rrezikohen banesa. Në qarkun e Vlorës, gadishulli i Karaburunit, vatra është mbajtur nën kontroll për të mos lejuar kalimin në Parkun Kombëtar të Llogarasë. Është mundur eliminimi i vatrave në pjesën më të madhe të zonës së prekur dhe momentalisht nuk ka rrezik.

8 vatrave të tjera në bashkinë Finiq (Vlorë), në fshatin Vermosh (Shkodër), në fshatrat Thirrë, Domgjonaj, Munellë (Lezhë), në Dropull (Gjirokastrë), në fshatin Klysyre (Tropojë), në fshatin Bardhaj (Dibër) si dhe në Kodër - Sharrë (Tiranë) u mbajtën nën kontroll dhe u monitoruan edhe gjatë natës, për të mos lejuar që ndryshimet e kushteve klimatike të ndikojnë në përhapjen e flakëve. Me ndërhyrjen edhe të 3 helikopterëve të mbërritur nga Holanda e Çekia si pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE pritej edhe shuarja përfundimtare e zjarreve.



Situata e zjarreve në vend, nisin punën helikopterët holandezë e çek

# 7 vatra aktive zjarri në vend, era përkeqëson situatën në Dukat e Kalimash

Në të gjithë vendin në datën 7 gusht ishin ende aktive 7 vatra zjarri. Në Dukat situata u paraqit kritike, pasi era ndikoi në përhapjen e flakëve, duke shtuar intensitetin e tyre. Rreth 200 trupa nga Forcat e Armatosura u vunë në gatishmëri për të bërë të mundur izolimin e zjarrit, ndërsa vijoi puna për shuarjen përfundimtare të flakëve në Gjirin e Gramës. Zjarri tek Maja e Rrunës, vatra në drejtimin nga vendi i quajtur Laku i Thive, në Kukës u vu nën kontroll, por u monitorua nga forcat operacionale. Ndërkohë që ishte aktiv zjarri sipër Tunelit të Kalimashit, ku situata u përkeqësua për shkak të erës, u punua për të mos lënë përhapjen në territorin e njësisë administrative Surroj, ku mund të kishte rrezik për stanet e fshatit. Puna vijoi pandërprerë me vatrat në fshatin Thirrë dhe fshatin Munellë-Domgjon, të bashkisë Mirditë, ku ende kishte vatra aktive në një pjesë të zonave. Në kontroll u vunë vatrat në fshatin Vermosh, në Malësi të Madhe, vatra në luginën e Valbonës në fshatin Klysyre si dhe vatra në fshatin Gjorgos në Cakran të Fierit. Zjarri i rënë në pyllin Shetaj afër Kepit të Rodonit në Durrës nuk paraqiti rrezik për zonat e banuara, por u mbajt nën monitorim. 3 vatra të tjera si ajo në fshatin Dëshiran në bashkinë Belsh, zjarri në vendin e quajtur "Varri i Nures", në kufi midis Përmetit dhe Skraparit në Bejkollarë, por edhe zjarri i rënë në zonat e mbrojtura, Parku Kombëtar, Bredhi i Hotovës-Dangëlli tashmë ishin shuar.

Në 7 gusht, ora 20.00, situata e zjarrit në Dukat u përmirësua, por puna e forcave operacionale vijoi për mbajtjen nën kontroll të flakëve nga toka. E vështirë u paraqit situata në fshatin Thirrë, në bashkinë Mirditë, ku zjarri përparoi duke u futur në zonë me dendësi pyjore. Aty forcat punuan për të ndërprerë vijën e zjarrit në afërsi të rrugës së fshatit. Në varësi të situatës mund të parashikohej edhe ndërhyrje nga ajri. Vatra e zjarrit në fshatin Munellë - Domgjon, në Fan të Mirditës u izolua në njërin anë, por kishte përhapje në pjesën e sipërme,



ku ndërhyrja ishte e vështirë. Edhe në Kukës në majën e Rrunës, ndërhyrja ishte e vështirë për shkak të terrenit, por situata u mbajt nën kontroll, në mënyrë që të mos kishte përhapje. Vatra të tjera, ishin nën kontroll në luginën e Valbonës, në fshatin Klysyre, në fshatin Gjorgos të Fierit, ku situata ishte e më e përmirësuar. Nuk kishte rrezik për banesat dhe u mbajtën nën monitorim vatrat; afër kepit të Rodonit në Durrës, një vatër në fshatin Dëshiran në bashkinë e Belshit, ku era ndërlikonte punën e forcave operacionale. Zjarri në fshatin Treblovë, në bashkinë Selenicë ndërkohë ishte shuar. Një vatër në terren të vështirë u paraqit në vendin e quajtur "Varri i Nures", në kufi midis Përmetit dhe Skraparit në Bejkollarë, por nuk rrezikoi përhapjen e flakëve. U punua për izolimin e tij.

Punonjësit e zjarrfikëses dhe emergjencave civile punuan për të mos lejuar përhapjen e flakëve në një vatër zjarri në zonat e mbrojtura Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, në fshatin Bejkollarë, në Gjirokastrë.

Më herët në datën 7 gusht u eliminua rreziku në vatrat e zjarrit në Dukat



e Gjirin e Gramës, por vijoi puna për izolimin e plotë të flakëve në të gjithë sipërfaqen e prekur në Gadishullin e Karaburunit, në qarkun e Vlorës. Gjithashtu u shua zjarri pranë pikës kufitare Rips në fshatin Livadhja, në bashkinë Finiq, duke shmangur rrezikun për banesat. Zjarri në fshatin Gjorgos, njësisë administrative Cakran, bashkia Fier u mbajt nën kontroll, ndërsa vijoi puna me helikopterin çek për shuarjen përfundimtare të tij. Në Kepin e Rodonit, në Durrës u raportua një vatër zjarri, për të cilën vijoi puna për vënien nën kontroll nga forcat në terren. Nuk

paraqiti rrezikshmëri.

Një vatër zjarri në një sipërfaqe me shkurre dhe ferra u raportua në malin e Xhyrës, në bashkinë e Librazhdit, por ai u shua nga forcat zjarrfikëse të bashkisë. Zjarri në fshatin Thirrë, njësisë administrative Fan, bashkia Mirditë vijoi të zgjerojë perimetrin, duke shkaktuar tym në të gjithë kodrën. Forcat punuan për të ndërprerë vijën e zjarrit në afërsi të rrugëve të fshatit. Ndërkaq u izolua plotësisht zjarri në fshatin Munellë-Domgjon, bashkia Mirditë, por vijoi të ishte e vështirë ndërhyrja për shkak të terrenit në Majën e Rrunës, në Kukës, ku

forcat punuan për të mos lejuar përhapjen e flakëve në zonat e banuara. Nën kontroll mbetën flakët në fshatin Klysyre të bashkisë Tropojë si dhe në Vermosh të Malësisë së Madhe.

U njoftua gjithashtu se prej orëve të para të mëngjesit të 7 gushtit u intensifikua puna për shuarjen e zjarreve në vatrat aktive të mbetura në të gjithë territorin e vendit. Zjarri në gadishullin e Karaburunit, njësisë administrative Orikum, bashkia Vlorë ishte eliminuar në pjesën më të madhe të vatrave, por që ishite riaktivizuar një vatër intensive në malin e Dukatit, e cila ishte e shuar pak ditë më parë. Në mbështetje të forcave tona operacionale ishtë ndërkohë edhe një helikopter i ardhur nga Holanda. Gjatë natës kishte patur një vatër të re në gjirin e Gramës, ku gjithashtu u punua për shuarjen e flakëve me forca të shtuara. Zjarri pranë pikës kufitare Rips në fshatin Livadhja, bashkia Finiq ishte në një terren të vështirë, por u mbajt nën kontroll për të shmangur rrezikun e banesave.

Një zjarr i rënë në fshatin Gjorgos, njësisë administrative Cakran, bashkia Fier angazhoi forcat operacionale prej orësh, të cilët punuan për ta mbajtur nën kontroll. Në mbështetje të tyre shkoi edhe helikopteri i ardhur nga Çekia.

Zjarri në Majën e Rrunës, njësisë administrative Malzi, bashkia Kukës, u mbajt nën kontroll, për të mos e lënë të përhapet në zona të banuara. Për shkak të terrenit të vështirë forcat nuk mund të ndërhyjnë dot në të gjithë zonën. Zjarri pranë luginës së Valbonës, fshati Klysyre, njësisë administrative Margegaj, bashkia Tropojë nuk pati përhapje dhe aktualisht ishte tërësisht i kontrollueshëm e me intensitet të ulët. Zjarri ishte nën kontroll edhe në fshatin Vermosh, njësisë administrative Kelmend, bashkia Malësi e Madhe.

Puna e forcave të emergjencave civile vijoi për të mbajtur nën kontroll flakët edhe në vatrat e hapura në fshatin Thirrë, njësisë administrative Fan, bashkia Mirditë si dhe në fshatin Munellë - Domgjon, po në këtë bashki.

## Forcat operacionale izolojnë gjatë natës pikën kritike, disa vatra zjarri mbeten ende problematike

Pavarësisht punës së pandërprerë të forcave të shtuara operacionale, në datën 08 gusht, ora 13.00, disa vatra zjarri ishin ende problematike në territorin e vendit siç ishte aktive vatra e zjarrit në Dukat të Ri. Pika kritike u izolua gjatë natës nga forcat operacionale, duke eliminuar rrezikun e kalimit të zjarrit në fshat, por përpjekjet për shuarjen e flakëve vazhduan nga toka dhe nga ajri.

Serioze ishte situata pranë Parkut Kombëtar të Llogarasë, ku u përqendruan të gjitha forcat, për të bërë të mundur normalizimin dhe izolimin e flakëve. Strukturat ishin në ndjekje të dinamikës, e cila ndryshonte për shkak të kushteve atmosferike. Një tjetër vatër serioze ishte ajo në fshatin Thirrë, në qarkun e Lezhës, ku puna vijoi për vënien nën kontroll nga ana e FA, punonjësvë të shërbimeve vendore, por edhe me ndërhyrje nga ajri. Vatra më e nxehtë ishte ajo në majën e Rrunës, në

Kukës pikërisht në pjesën sipër tunelit të Kalimashit. Ndërkohë u vu nën kontroll vatra në zonën e quajtur Laku i Thive. Puna vijoi edhe në pjesën që ndodhet në fshatin Munellë - Domgjon, në Mirditë, ku kishte situatë aktive. U raportuan edhe disa vatra të reja, njëra në fshatin Patalej në Lezhë, një tjetër vatër në Gjallicë në Kukës, me përmasa të vogla, si dhe një vatër në fshatin Cakran të Fierit, e cila ishte shuar 10 ditë më parë nga FA por që ishte riaktivizuar. Si pasojë e përkeqësimit të gjendjes dhe përmasave që moën flakët shkuan në ndihmë edhe 40 efektivë të FA. Një vatër e re u njoftua në pyllin e fshatit Gjorgos në Fier, ku për shuarjen e zjarrit u angazhuan forcat zjarrfikëse të Roskovecit.

Nën monitorim u vunë zjarret e rena në fshatin Vermosh në Malësi të Madhe dhe në pyllin Shetaj afër kepit të Rodonit në Durrës. Këto vatra nuk paraqitën rrezik për zonat e banuara.



STRUKTURAT E KM VIJOJNË PUNËN PËR SHUARJEN E ZJARREVE NË DISA ZONA TË VENDIT

## Komanda Mbështetëse angazhoi 837 forca dhe 116 mjete

**K**omanda Mbështetëse me efektivat e strukturave të vartësisë vijon angazhimin për shuarjen e zjarreve në disa rajone të vendit. Angazhimi i strukturave të KM ka filluar që nga data 2.08.21 dhe vijon deri në ditet e sotme DMR-t Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë si dhe efektivate EOD dhe efektivat e Batalionit të Furnizimit, të mbështetura me automjeteve të Batalionit të Transportit, janë angazhuar që në momentet e para të rënies së zjarreve në Ksamil të Sarandës, Vithkuq të Korçës, Kutal të Përmetit, gadishullin e Karaburunit, Fushë - Dukat të Vlorës, Qesarat, Lunxhëri, Trashonisht, Saraçinisht, zona

e Antigonesë dhe Mashkullorë të Gjirokastrës.

Gjithashtu, në zonën veriore të vendit efektivat e DMR Kukës në bashkëpunim me zjarrfikësit e qytetit dhe ndërmarrjen pyjore janë angazhuar në shuarjen e vatrave të zjarreve në Shemri Kukës, Maja e Qerhisë, Njesia Administrative Surroj, Maja e Runës, Qafa e Kumllës dhe mali i Thirtës në Mirditë.

Kete vatrë ndodhen kryesisht në zona malore e tepër të thepisura dhe si pasojë e erës situata rëndohet, duke vështirësuar punën. Deri në datën 10 gusht nga Komanda Mbështetëse janë angazhuar 837 forca dhe 116 mjete.



# Efektivat e KM për shuarjen e zjarreve në parqet kombëtare të Llogarasë, Antigonesë dhe manastirin e Shën Pjetrit

**S**i pasojë e vatrave të zjarrit të shtuara për shkak të erës, dhe pamundësisë së menaxhimit nga pushteti vendor, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në datën 5 gusht 2021 ka kërkuar angazhimin dhe ndërhyrjen e Forcave të Armatosura për shuarjen e zjarreve dhe kthimin e situatës në normalitet. Operacionet e shuarjes së zjarreve nga ana e KM janë zhvilluar kryesisht në Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë në zona të thepisura malore, por ka patur raste edhe pranë zonave të banuara e zonave të shpallura pasuri kombëtare si në rastin e parkut kombëtar të Llogarasë.

Më konkretisht, efektivat e Batalionit të Mbështetjes Rajonale janë angazhuar në Fushë - Dukat të Vlorës dhe në bashkëpunim me forcat zjarrfikëse të qytetit Vlorë kanë vënë në kontroll situatën. Më pas vatra zjarresh janë evidencuar edhe pranë Parkut Kombëtar të Llogarasë. Menjëherë të gjitha forcat kanë përqendruar të gjitha përpjekjet në drejtim të parkut duke mos lejuar përhapjen flakëve e duke bërë të mundur shuarjen e tij.

Paralelisht një pjesë tjetër e personelit janë angazhuar në zonën e Antigonesë, fshatrat Arshi Lengo, Asim Zenel, Qesarat si dhe në Lunxhëri në fshatrat Trashonisht e Saraçinisht të qarkut Gjirokastrë duke vënë nën kontroll vatrën e zjarreve të shkaktuara në këto zona deri në shuarjen totale të tyre ditën e djeshme në mëngjes. Gjatë pasdites



janë raportuar vatra të tjera të izoluar të cilat përsëri janë shuar.

Një tjetër vatrë zjarri u evidencua në Vithkuq të Korçës. Forcat e mjetet e DMR Korçë shkuan menjëherë dhe punuan intensivisht për shuarjen e tij. Përpjekjet u përqendruan në ruajtjen e manastirit të Shën Pjetrit duke eliminuar rrezikun e djegies së tij.

Vatrën e zjarreve përhapshin me shpejtësi, si pasojë e erërave të forta, duke rrezikuar në disa raste edhe qendrat e banuara dhe vetë banorët

e zonave siç ndodhi në qytetin e Gjirokastrës. Për këtë arsye, efektivat e të gjithë reparteve të Komandës Mbështetëse kanë punuar me orë të zgjatura e deri në orët e vona të natës për të shuar zjarret dhe eliminuar rrezikun që u kanosej banorëve, pronës së tyre private, pronës publike dhe aseteve të shpallura pasuri kombëtare. Aktualisht, këto zona janë vënë nën kontroll dhe po mbahen nën vëzhgim në rast shfaqjesh të vatrave të tjera të zjarrit. Gatishmëria vijon.



## Viti i ri Akademik 2021-2022

# Datat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve

**D**atat e regjistrimit të aplikantëve për konkursin e pranimeve për Vitin Akademik 2021-2022 raundi i parë do të jenë 6 - 13 gusht 2021, nga ora 9.00-16.00 (aplikantët para se të bëjnë pagesën duhet të verifikojnë emrin në listat e afishuara në AFA dhe në portalin ualbania.al). Shpallja e listave të aplikantëve të regjistruar për konkurrim në AFA - FMS do të bëhet në datën 13 gusht 2021. Datat e konkursit institucional në FMS - AFA do të jenë 16 - 20 gusht 2021. Konkretisht çdo testim do të zhvillohet sipas grafikut që do ju behet i ditur ditën e regjistrimit.

Dokumentet që duhet të ketë kandidatit për regjistrim në konkurs: Mandat pagesa e tarifës së konkurimit (2000 lek), dokumentin e identifikimit (karte identiteti ose pasaporte). Ne dosje mbahet vetëm fotokopja; - fotokopjen e noterizuar te diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose te një dëftesë/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe te njehsuar në QSHA; listën e notave; deklaratën e paraqitur në shtojcën nr.10 bashkëlidhur udhëzimit të MASR nr. 10, nr.10, datë 15.05.2019 'Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë, të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara të ciklit të dyte te studimeve, ne institucionet



e arsimit te larte', të ndryshuar". e cila plotësohet nga aplikanti ne prani të punonjësës se sekretarisë mësimore te AFA-së dhe qe nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e secretaries, kërkesën me shkrim; formularin me të dhëna personale, sipas formatit të përcaktuar në Aneksin A, bashkëlidhur këtij dokumenti; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; certifikatë familjare, 1 copë; formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore, i cili plotësohet pranë Sekretarisë së AFA-së, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit, sipas Aneksit B, bashkëlidhur këtij dokumenti; formular i vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (www.mod.gov.al/baza ligjore); raport mjekësor i aftë për studime, lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike; - ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e

gjakut dhe lëndë narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndë narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në përfundim të konkursit institucional: Aplikantët /kandidatët që janë shpallur fitues në testimet e zhvilluara, pas shpalljes së tyre fitues në portalin ualbania.al duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë mësimore të AFA-së edhe dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përbarimi; Afati për tu regjistruar dhe dorëzuar dokumentacionin e mësipërm është 2 -15 shtator.

Të dhënat për Rregulloren e konkursit, testeve dhe fatura e tarifës konkurimit gjenden në faqen zyrtare të AFA dhe të MMBrenda datës 30 Gusht 2021, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë do të afishojë dhe publikojë listën e renditjes së aplikantëve fitues duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre.

### Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve

HAJRIE DEDAJ

**S**tina e verës, është stina që ofron mundësinë për t'u shpërndur, për t'u shkëputur nga përditshmëria dhe vrulli i punës edhe për ushtarakët dhe civilët e FA, si dhe familjarët e tyre. Pushimet ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor dhe na bëjnë të jemi edhe më të motivuar dhe produktivë. Një pushim mund të na ndihmojë të ndihemi të freskët dhe më të përgatitur për të përballur gjithçka, që vjen kur kthehemi.

Të mëdhenj dhe të vegjël, presin për të shkuar dhe pushuar në vendet e tyre të preferuara dhe Shqipëria është një vend me një vijë bregdetare shumë të pasur, që të ofron mundësinë e plazheve mahnitëse me bukurinë përallore të natyrës dhe jo vetëm. Por përveç këtyre plazheve, ushtarakët dhe familjarët e tyre pushimet verore i kryejnë në Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve në Durrës, Pogradec dhe Jalë.

**Jala qendra e aktiviteteve të kësaj vere**

Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve në Jalë si çdo herë tjetër edhe këtë verë ka pritur pushues ushta-

## QKMBMMFA organizon aktivitete artistike këtë verë në Jalë



rakë dhe civilë, si dhe familjarë e tyre, të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë të Mbrojtjes. Institucioni i QKMBMMFA kujdeset që gjatë verës për pushuesit në Shtëpitë e Ushtarakëve të mos mungojnë aktivitete. Me një përkushtim të jashtëzakonshëm nga drejtuesit e Qendrës së Kulturës realizohen shfaqje, koncerte etj. Pjesëmarrës në këto aktivitete janë specialistët e QKMBMMFA Kozma Dushi, Redon Makashi, Sajmir Braho apo Elton Deda dhe si gjithmonë të shoqëruar nga drejtuesi i Sektorit të Aktiviteteve Gazmend Çaçi. Koncertet do jenë në një interval kohe prej 7 ditësh dhe vendi që është zgjedhur për tu mbajtur aktivitete këtë vit është Jala një nga vendet më të bukura dhe më të veçanta për detin, ujin, rërën një bukuri natyrore unike e bregdetit tonë jonian. Datat të cilat janë vendosur është e mërkura e çdo jave e muajt gusht 4,11,18,25. Kjo traditë disa vjeçare tashmë e Qendrës së Kulturës bën që edhe gjatë muajve të verës të punohet me po të njëjtin intesitet për tju ofruar mbremje të gëzueshme ushtarakëve, por jo vetëm në shtëpitë e tyre të pushimit.



# Gushti 1949: Provokacion apo agresion ushtarak?



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

**M**ë 2 gusht 1949 në zonën kufitare në Juglindje të Shqipërisë me bazë në rajonet e Korçës, të Leskovikut dhe deri në Konispol të Sarandës e në Likojan, u kryen veprime ushtarake në shkallë të gjerë nga shteti i Greqisë. Këto veprime të armatosura ushtarake nuk ishin thjesht provokacion apo provokacion ushtarak (i armatosur) siç është cilësuar nga shteti shqiptar në vitin 1949, e që vazhdon të trajtohet nga historia zyrtare shqiptare, si dhe nga studiues civil dhe ushtarak, por agresion ushtarak.

Natyrisht, më tipike për nga përmasat dhe kohështirja janë “provokacionet” e forcave monarko-fashiste greke, në Gusht 1949. Këto provokacione, parë nga qëllimi, hapësira, shtrirja territoriale, intensiteti i goditjeve e pjesëmarrja e forcave, pavarësisht motiveve publike të shpallura nga udhëheqja e lartë greke, sipas studiuesve të ndryshëm ushtarakë, përbëjnë një agresion të mirëfillt ushtarak me përmasa dhe objektiva të kufizuara ushtarake ndaj RPSH. Këto “provokacione” nuk u shtrinë në pika apo objekte të veçanta, që janë tipike për provokacionet, por në gjithë kufirin e Jugut, nga Kapshtica, Bozhigradi, Leskoviku e deri në Konispol (2 gusht-5 shtator 1949). Objektivi ishte kryesisht pushtimi i qarkut të Korçës, ku dhe përpjekjet ishin më të ashpra e me pjesëmarrje shumë të gjerë forcash ushtarake, sikurse dhe pushtimin mundësisht të Gjirokastrës, nën petkun kundër lëvizjes partizane greke e rrugëve të furnizimit nga Shqipëria.

Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe thuhet se provokacioni është goditje e ndeshje me armë, e organizuar qëllimisht nga një shtet... kundër një vendi të pavarur, për të krijuar shkak për ndërhyrje të armatosur e për të sjellë trazira. Shteti grek dhe Forcat e tij të Armatosura kishin vite që provokonin, kryesisht në të gjithë vijën kufitare, nga Prespa deri në kanalën e Korfuzit e që ndërmerrnin akte të tilla, por në vitin 1949, duke filluar që nga janari ato do të përshkallëzoheshin pak nga pak, duke ardhur tek 2 gushti 1949, që në mënyrë masive nisi sulmi i armatosur kundër vendit tonë.

Përsëri, po në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe theksohet se agresion i armatosur është “Sulm i armatosur i një shteti kundër një shteti tjetër për t'i pushtuar tokat e për ta nënshtruar, për të shtypur lëvizjet demokratike, revolucionare ose nacionalçlirimtare dhe për të vendosur regjime reaksionare; luftë e ashpër që bën një shtet për të depërtuar me mënyra të ndryshme në një shtet tjetër e për ta dëmtuar nga ana ekonomike, politike, ideologjike e kulturore”.

Në rezultat të ballafaqimeve të dy forcave ushtarake, por dhe të shpjegimit të fjalorit të gjuhës shqipe del se nuk ka



qenë provokacion, por agresion ushtarak. Këtu kemi parasysh qëllimin, objektivat politikë, forcat pjesëmarrëse (ku pala greke i kishte të organizuara Forcat e Armatosura në të tre llojet e tyre), grupimi i forcave dhe mjeteve, pjesëmarrëse në agresion, kohështirja, që është jo tipike për incidentet dhe provokacionet, por për një agresion, në rastin konkret me synime dhe objektiva të kufizuara (jo e përfshirë në të gjithë territorin e vendit), por të një pjese të tij dhe posaçërisht në atë që gjithmonë pala greke e quan “Epiri i Veriut”. Agresioni ushtarak i ndërmarrë nga forcat monarko-fashiste greke ishte një agresion ushtarak me objektiva të pjesshme dhe në përfundim edhe agresion ushtarak me objektiva vendimtar.

## Agresioni ushtarak për pushtim

Analiza e veprimeve luftarake të FA greke të gushtit 1949, tregon qartë se nuk kemi të bëjmë me një incident, as provokacion, por me një luftë të armatosur me të gjitha format, metodat, qëllimet, karakteristikat dhe elementet e një agresioni ushtarak për pushtim, ku vihen përballë dy shtete dhe Forcat e tyre të Armatosura. Nuk ka rëndësi se u zhvillua në një pjesë të kufirit e territorit të vendit, por qëllimet ishin të plota, kapja dhe mbajtja e territorit të përcaktuar prej tyre. Veprimi ushtarak i armatosur grek i 2 gushtit 1949, ishte vazhdim i idesë së kahershme aneksioniste për pushtimin e të ashtuquajturit “Vorio-Epiri”. Greqia nuk kishte dhe madje nuk ka abroguar edhe sot e kësaj dite ligjin e luftës, nuk ka hequr dorë prej synimit të saj. Tërë dokumentacioni ushtarak arkivor i ngjarjeve konkrete, nga të dy forcat luftuese, i dëshmitarëve, i shkrimeve dhe kronikave të kohës, tregojnë për një agresion ushtarak mirëfillt, të forcave greke kundër vendit tonë.

Në këto vite të shtetit shqiptar, të pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe të kohës së demokracisë, qarqet e caktuara

greke luftonin e luftonin për të arritur këtë qëllim, duke vënë në përdorim propagandën mediatike, lobimet intriguese me Fuqitë e Mëdha, fenë, policinë sekrete, diplomacinë, kërcënimet, deklaratat për sulm, paradat ushtarake për zhdukje shqiptarësh, emisarë të saj në Shqipëri, financimet e qarqeve shoviniste brenda e jashtë Shqipërisë, incidentet kufitare, tendenca për kontroll e prezencë aktive mbi ekonominë, pushtetin, drejtësinë, bankat,



fenë, kulturën dhe historinë e Shqipërisë, madje edhe duke përpunuar e përdorur politikën dhe shtetin shqiptar. 2 gusht 1949 ishte fillimi, por sulmet vijuan gjatë gjithë muajit gushtit. Dokumentet faktike të forcave monarko-fashiste greke që u përdorën kundër Shqipërisë, tregojnë se në ushtrinë e tyre kishin topa, avionë, ushtri tokësore e gjithçka që përdor një Forcë e Armatosur e një vendi që synon të pushtojë një vend tjetër. Ushtria Kombëtare Shqiptare, iu kundërpërgjigj sulmit pushtues grek, me luftë të armatosur, në mbrojtje të kufijve e trojeve të sulmuara.

Forca monarko-fashiste të Greqisë sulmuan Shqipërinë me mbi 70 mijë ushtarë, 50 avionë, 80 tanke dhe një skalion artilerie me afro 400 gryka zjarri, kryesisht topa. Ushtria Kombëtare Shqiptare mobilizoi dhe futi në luftimet aktive mbrojtëse rreth 10 mijë ushtarë, ndërkohë kryen rigrupim e përqendrim pranë rajonit të veprimeve luftarake rreth 30 mijë trupa të tjerë, në gatishmëri për të vepruar në fushën e betejës.

## U kryen veprime luftarake në masë

Veprimet luftarake edhe pse të shkëputura e si provokacion, të cilat kryeshin prej shumë kohësh më përpara vazhduan me intensitet më të lartë nga 2 gushti deri në 5 shtator 1949. Me ndërprerje ato u shtrinë në zonat e Bilishtit, Kapshticës, Leskovikut dhe Konispolit. Shqipëria pësoi dëme në njerëz, ushtarakë dhe civilë të vrarë, si dhe dëme materiale në fshatrat pranë kufirit. Forcat monarko-fashiste greke, lanë mjaft ushtarë të vrarë në territorin shqiptar, si dhe rob luftime.

Shteti shqiptar i ndoqi me vëmendje zhvillimet politike e sidomos ushtarake mes dy vendeve. Ai e kishte mësuar lajmin për sulmin e forcave monarko-fashiste greke në fillim të korrikut 1949. Ushtria shqiptare ishte e gatshme në raport të drejtë me intensifikimin e veprimeve dhe në gatishmëri, pasi forcat monarko-fashiste greke kishin rreth 8

shkoi më pranë veprimeve luftarake dhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm me në krye shefin e Shtabit të FA, Beqir Balluku.

Plani, dita dhe ora e sulmit të forcave monarko-fashiste greke ishte i zbuluar nga D8K i Korçës. Forcat monarko-fashiste greke kishin 8 muaj që bënin provokacione të vijueshme në kufirin shqiptar. Në këto provokacione nga që synimet greke nuk kishin mundur të shkaktonin acarim të palës shqiptare për nisje konflikti, kaluan në veprime luftarake në masë, të koordinuara. Pala greke, duke u dhënë një përmbajtje të re veprimeve të saj, kaloi në veprime më masive. Mësymjen nga toka, po e mbështeste jo vetëm me zjarrin e artilerisë, por edhe të aviacionit. Veprimet luftarake midis dy palëve, duke tejkaluar përmasat e provokacioneve të shkëputur, po merrnin gjithnjë e më shumë karakterin e luftës me front të rregullt. Të dëshpëruar dhe të acaruar, në 2 gusht 1949, në orën 04.30, në zonën e Bozhigradit (Mirasi) filloi përgatitja me artileri e forcave ushtarake greke, të dislokuara përgjatë kufirit me Shqipërinë. Predhat ranë rreth 300-400 m në thellësi të territorit shqiptar. Në orën 05.00 filloi sulmi i fanterisë greke me 3 batalione të Br51F dhe Br52F të D1F, të mbështetur nga një Regjiment Artilerie dhe një skuadrilje aeroplanësh gjuajtës, të tipit “Spitfiter”, me bazë në aerodromin e qytetit Kastoria. Kështu u nis sulmi i agresionit ushtarak.

muaj në “shënjestër” kufirin shqiptar në zonën Leskovik-Korçë. Forca të shkëputura monarko-fashiste greke sajnin dhe nxitnin provokacione ndaj kufitarëve shqiptarë, përdorën agjentë të shërbimit sekret gjatë kufirit, krijonin konflikte provokuese me forca ndaj banorëve të zonës kufitare. Para kësaj, përballë forcave greke në rajonin e Korçës ishte vendosur D8K në brezin Vidohovë-Vernik-Qafa e Zvezdës-Mali Rrumbullakët. Me rëndimin e situatës e intensifikimin e veprimeve luftarake me vendim të Komandës së Përgjithshme

Studimi i agresionit ushtarak të gushtit të vitit 1949 përbën një pjesë të rëndësishme të historisë së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, të Forcave të Armatosura dhe të popullit shqiptar. Trajtimi i këtij agresioni është një detyrë e rëndësishme e historiografisë shqiptare në përgjithësi dhe të asaj ushtarake në veçanti. Edhe pse agresioni ushtarak i gushtit të vitit 1949 nuk ka mbetur jashtë vëmendjes të historiografisë shqiptare, studimet për të, sidomos të karakterit monografik-ushtarak kanë qenë dhe janë tepër të kufizuara.

# Mjedisi i sotëm i sigurisë, rezistenca dhe neni 3

MSC. MIMOZA GOLIKJA

**C**do vend anëtar i NATO-s duhet të jetë elastik për të rezistuar dhe për të marrë veten nga një goditje e madhe si një fatkeqësi natyrore, dështimi i infrastrukturës kritike, një sulm hibrid ose i armatosur. Qëndrueshmëria është aftësia e një shoqërie për t'i rezistuar dhe shëruar nga goditjet e tilla dhe kombinon gatishmërinë civile dhe kapacitetin ushtarak. Gatishmëria civile është një shtyllë qendrore e elasticitetit të aleatëve dhe një mundësi kritike për mbrojtjen kolektive të Aleancës, dhe NATO mbështet aleatët në vlerësimin dhe rritjen e gatishmërisë së tyre civile.

Parimi i elasticitetit është theksuar në Nenin 3 të Traktatit themelues të Aleancës: "Për të arritur në mënyrë më efektive objektivat e këtij Traktati, Palët, veçmas dhe së bashku, me anë të vetë-ndihmës dhe ndihmës reciproke të vazhdueshme dhe efektive, do të mbajnë dhe të zhvillojnë kapacitetin e tyre individual dhe kolektiv për t'i rezistuar sulmeve të armatosura."

Neni 3 ndihmon për t'i dhënë NATO-s mjetet për të përmbushur detyrat e saj kryesore, në veçanti, atë të mbrojtjes kolektive. Angazhimi individual i secilit dhe çdo aleati për të ruajtur dhe forcuar elasticitetin e tij zvogëlon cenueshmërinë e NATO-s në tërësi.

Kurse qëndrueshmëria është para së gjithash një përgjegjësi kombëtare dhe çdo aleat duhet të jetë mjaft i fuqishëm dhe i përshtatshëm për t'u marrë dhe trajtuar të gjithë spektrin e krizave të parashikuara nga Aleanca. NATO ka rënë dakord për shtatë kërkesat bazë për elasticitetin kombëtar kundrejt të cilave aleatët mund të matin nivelin e tyre të gatishmërisë; këto kërkesa pasqyrojnë funksionet kryesore të vazhdimësisë së qeverisë, shërbimet thelbësore për popullatën dhe mbështetjen civile për ushtrinë.

Përpykjet ushtarake për të mbrojtur territorin dhe popullatat e Aleancës nga ana tjetër, duhet të plotësohen me gatishmëri të fortë civile për të zvogëluar dobësitë e mundshme dhe rrezikun e sulmit në kohë paqeje dhe gjatë luftës. Forcat ushtarake, veçanërisht ato të vendosura gjatë krizave dhe luftës, varen shumë nga sektorët civilë dhe tregtarë për transportin, komunikimet dhe madje edhe furnizimet bazë si ushqimi dhe uji, për të përmbushur misionet e tyre

## Dobësitë në një mjedis sigurie në ndryshim

Mjedisi i sotëm i sigurisë është i paparashikueshëm. Kërcënimet mund të vijnë nga aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në formën e sulmeve terroriste, por edhe sulme kibernetike dhe luftëra hibride, të cilat mund të turbullojnë kufijtë midis formave konvencionale dhe jo konvencionale të konfliktit. Ato gjithashtu mund të vijnë nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore si përmytjet, zjarret dhe tërmetet, dhe nga rreziqet biologjike siç është pan-



demia COVID-19. Sfida e përshtatjes dhe përgjigjes ndaj këtyre llojeve të ndryshme të kërcënimeve është e përbërë nga tendencat që kanë transformuar rrënjësisht mjedisin e sigurisë.

Rënia e buxheteve të mbrojtjes që nga fundi i Luftës së Ftohtë ka rritur gradualisht mbështetjen e përgjithshme në asetet dhe aftësitë civile dhe tregtare. Si pasojë, burimet civile dhe infrastruktura kritike tani, në shumë zona, janë në pronësi dhe operohen nga sektori privat. Disa shifra ilustronë shtrirjen e kësaj: rreth 90 për qind e transportit ushtarak për operacione të mëdha ushtarake është marrë me qira ose kërkohet nga sektori tregtar; mesatarisht, mbi 30 për qind e komunikimeve satelitore të përdorura për qëllime mbrojtëse sigurohen nga sektori tregtar; dhe rreth 75 për qind e mbështetjes së kombit priten për operacionet e NATO-s buron nga infrastruktura dhe shërbimet komerciale vendore.

Me zvogëlimin e investimeve ushtarake dhe privatizimin e aseteve të zotëruara më parë nga qeveria, është zhvilluar një mbështetje e madhe tek mundësitë civile, të lidhur me praktikatat tregtare. I shtyrë nga disa objektiva duke përfshirë maksimizimin e efikasitetit, sektori privat ka eliminuar shumicën e tepricave, të cilat janë të kushtueshme për biznesin. Sidoqoftë, asete të ndryshme në pronësi private janë kritike për ruajtjen e vazhdimësisë së qeverisë dhe shërbimeve thelbësore në një krizë të mundshme me ndikim të lartë. Gjatë Luftës së Ftohtë, për shembull, kishte mekanizma dhe aftësi të mbrojtjes territoriale të gatshme për të mbështetur një përpjekje lufte, por ato nuk ekzistojnë më.

Për më tepër, me përdorimin e gjerë të teknologjive të reja, shoqëritë tona janë bërë të ndërlidhura dhe të ndërvarura në fushat ekonomike, financiare, të informacionit dhe kibernetike. Një ndërvarësi e tillë ka qenë një forcë e madhe dhe një përfitim domethënës për shoqëritë tona, por gjithashtu mund të krijojë dobësi dhe të krijojë varësi.

## Forcimi i elasticitetit

Sa më mirë të jenë të përgatitur aleatët, aq më pak ka të ngjarë të jenë të prekshëm dhe potencialisht më pak të mund të sulmohen, duke e bërë NATO-n në tërësi më të fortë. Aleatët mund të forcojnë elasticitetin, për shembull, përmes zhvillimit të kapacitetit të tyre kombëtar të mbrojtjes, qasjes së siguruar në infrastrukturën kritike dhe zhvillimit të planeve mbështetëse në rast krizash; ata gjithashtu mund të testojnë rregullisht aftësinë e tyre për të ofruar shërbime vitale dhe mbështetje për forcat ushtarake, duke përdorur instrumente civile, tregtare ose të tjera.

Puna e NATO-s për të përmirësuar elasticitetin nuk është specifike për ndonjë dobësi të vetme. Ajo kontribuon në mbrojtjen e territorit dhe popullsisë së Aleancës nga të gjitha rreziqet e mundshme. Në Samitin e vitit 2016 në Varshavë, udhëheqësit aleatë vendosën të rrisin qëndrueshmërinë e NATO-s ndaj spektrit të plotë të kërcënimeve dhe të vazhdojnë zhvillimin e kapaciteteve individuale dhe kolektive për t'i rezistuar çdo forme sulmi të armatosur. Ata ranë dakord për shtatë kërkesat bazë për elasticitetin kombëtar kundrejt të cilave shtetet anëtare mund të matin nivelin e tyre të gatishmërisë.

Këto kërkesa pasqyrojnë funksionet kryesore të vazhdimësisë së qeverisë, shërbimet thelbësore për popullatën dhe mbështetjen civile për ushtrinë, e cila duhet të mbahet në rrethanat më të vështira. Ata janë të gjithë të lidhur, që do të thotë nëse një zonë ndikohet, një tjetër mund të vuajë si rezultat. Vazhdimësia e garantuar e shërbimeve qeveritare dhe kritike qeveritare: për shembull aftësia për të marrë vendime, komunikuar ato dhe zbatuar ato në një krizë; Furnizime elastike me energji: plane rezervë dhe rrjete të energjisë, brenda dhe përtej kufijve; Aftësia për t'u marrë në mënyrë efektive me lëvizjet e pakontrolluara të njerëzve dhe për t'i de-konfliktuar këto lëvizje nga dislokimet ushta-

rake të NATO-s; Burimet elastike të ushqimit dhe ujit: duke siguruar që këto furnizime të jenë të sigurta nga përçarja ose sabotimi; Aftësia për t'u marrë me viktimat masive: duke siguruar që sistemet shëndetësore civile mund të përballojnë dhe se furnizimet e mjaftueshme mjekësore janë të pajisura dhe të sigurta; Sisteme elastike të komunikimit civil: duke siguruar që telekomunikacioni dhe rrjetet kibernetike të funksionojnë edhe në kushte krize, me kapacitet të mjaftueshëm rezervë. Kjo kërkesë u përditësua në Nëntor 2019 nga ministri i Mbrojtjes të NATO-s, të cilët theksuan nevojën për sisteme të besueshme komunikimi duke përfshirë 5G, opsione të fuqishme për të rivendosur këto sisteme, qasje me përparësi tek autoritetet kombëtare në kohë krize dhe vlerësime të plota të të gjitha rreziqeve për sistemet e komunikimit; Sistemet elastike të transportit: duke siguruar që forcat e NATO-s të mund të lëvizin në të gjithë territorin e Aleancës me shpejtësi dhe se shërbimet civile mund të mbështeten në rrjetet e transportit, edhe në një krizë.

Zbatimi i këtij angazhimi është një përparësi kryesore për aleatët. Që nga viti 2016, elasticiteti i anëtarëve aleatë është përmirësuar, por sfidat dhe mangësitë mbeten. Në të njëjtën kohë, aleatët përballen me sfida të reja, duke përfshirë presionet ekonomike që mund të minojnë aksesin e siguruar të infrastrukturave thelbësore kritike nga qeveritë kombëtare dhe ushtria në kohë krize. NATO përditësoi kërkesat e saj bazë në vitin 2020 për të pasqyruar sfidat e paraqitura nga teknologjitë e komunikimit në zhvillim, siç është 5G, si dhe ndikimin dhe implikimet e pandemisë COVID-19.

Në të vërtetë, pandemia aktuale është një kohë kur elasticiteti po testohet. NATO dhe aleatët kanë

punuar vazhdimisht për të rritur gatishmërinë në të gjithë qeverinë, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë. Në mbështetje të aleatëve, organi kryesor i NATO-s që adreson gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë, Komiteti i Planifikimit të Emergjencave Civile, po monitoron dhe vlerëson ndikimin e krizës dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe praktikatat më të mira midis aleatëve në baza të vazhdueshme.

## Forcimi i bashkëpunimit civil-ushtarak

Vëmendja e përtërirë ndaj elasticitetit po çon në rritjen e bashkëpunimit midis palëve të interesuara civile dhe ushtarake. Marrëveshjet bashkëpunuese mes tyre po dëshmojnë përfitim reciprok, si në kohë paqeje ashtu edhe në krizë. Për shembull, siç ka treguar pandemia COVID-19, ndihma ushtarake për autoritetet civile ka qenë një mbështetje kritike kur burimet civile janë nën stres të rëndë.

Ushtrimet janë një mënyrë efektive për të kryer teste stresi të aranzhimeve kombëtare, veçanërisht kur bëhet fjalë për raste të paparashikuara në shkallë të gjerë të tilla si një sulm me armë të shkatërrimit në masë ose që kanë të bëjnë me aspekte të caktuara të luftës hibride. Në këtë aspekt, elasticiteti është një fushë e rëndësishme për analiza dhe mjete të reja vlerësimi janë duke u zhvilluar në mënyrë që të përmirësohet mënyra se si Aleanca dhe anëtarët e saj identifikojnë dobësitë, vlerësojnë gatishmërinë e tyre dhe përmirësojnë kapacitetin e tyre.

## Partneriteti për të forcuar elasticitetin

Rritja e elasticitetit dhe gatishmërisë civile është gjithashtu pjesë e mbështetjes së NATO-s për partnerët dhe një mënyrë për të projektuar stabilitetin në fqinjësinë e Aleancës. Shembuj të bashkëpunimit praktik përfshijnë vendosjen e ekipëve të ekspertëve të gatishmërisë civile në mbështetje të Ukrainës dhe Irakut, dhe krijimin e një projekti të përbashkët trevjeçar të OKB-NATO për të ndihmuar Jordaninë në përmirësimin e gatishmërisë së saj në fushën e kimikateve, biologjike, radiologjike dhe armët bërthamore (CBRN).

NATO gjithashtu bashkëpunon me sektorin privat dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Bashkimi Evropian, në veçanti, mbetet një partner unik dhe thelbësor për Aleancën, veçanërisht përmes konsultimeve personel me personel dhe bashkëpunimit praktik në një numër fushash.

# Misioni "Resolute Support" në Afganistan

Misioni i drejtuar nga NATO Resolution Mission (RSM) në Afganistan u nis më 1 janar 2015, pas përfundimit të misionit të Forcës së Ndihmës së Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF). Qëllimi i tij ishte të sigurote trajnime, këshilla dhe ndihmë të mëtejshme për forcat dhe institucionet afgane të sigurisë. Në prill 2021, aleatët vendosën të fillojnë tërheqjen e forcave RSM deri më 1 maj 2021. Tërheqja e të gjitha forcave të SHBA-së dhe RSM duhet të përfundojë brenda pak muajsh. Aleatët dhe partnerët e NATO-s do të vazhdojnë të mbështesin procesin e paqes në pronësi afgane dhe të udhëhequr nga afganët drejt një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse politike.

## Funksionet dhe organizimi i RSM

Mbështetja e vendosur ishte një mision jo-luftarak i drejtuar nga NATO. Misioni u krijua me ftesë të qeverisë afgane dhe në përputhje me Rezolutën 2189 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB) të vitit 2014. Qëllimi i tij ishte të ndihmonte forcat dhe institucionet afgane të sigurisë të zhvillonin kapacitetin për të mbrojtur Afganistanin dhe për të mbrojtur qytetarët e tij në një mënyrë të qëndrueshme. Deri në gusht 2020, RSM kishte rreth 10,000 personel nga 36 shtete anëtare të NATO-s dhe vende partnere të vendosura në Afganistan. Këto forca po zvogëlohen në zero, ndërsa vendimi për tërheqjen pas prillit të 2021 vazhdoi.

RSM operonte me një qendër qendrore (në Kabul/Bagram) dhe katër zëra në Mazar-e Sharif, Herat, Kandahar dhe



Laghman. Ai u përqendrua kryesisht në trajnimin, këshillimin dhe aktivitetet e asistencës në ministrinë e lidhura me sigurinë, në institucionet e sigurisë së vendit dhe në radhët e larta të ushtrisë dhe policisë. Ajo punoi ngushtë me elementë të ndryshëm të ushtrisë afgane, policisë dhe forcave ajrore.

## Funksionet kryesore

Funksionet kryesore të përfshira ishin, Mbështetja e planifikimit, programimit dhe buxhetimit; Sigurimi i transparencës, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes; Mbështetja e respektimit të parimeve të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë; Mbështetja e krijimit dhe mbajtjes së proceseve të tilla si gjenerimi i forcës, rekrutimi,

trajnimi, menaxhimi dhe zhvillimi i personelit.

## Vendimet kryesore dhe evolucioni i RSM

Vendimi për të nisur një mision jo-luftarak të udhëhequr nga NATO, për të vazhduar mbështetjen e zhvillimit të forcave afgane të sigurisë pas përfundimit të misionit ISAF në dhjetor 2014 u ra dakord bashkërisht midis aleatëve dhe partnerëve me qeverinë afgane në Samitin e NATO-s në Çikago në 2012. Ky angazhim u riafirmua në Samitin e Uellsit në 2014.

Kuadri ligjor për RSM u siguroi nga një Marrëveshje për Statusin e Forcave (SOFA), e cila u nënshkrua në Kabul më 30 shtator 2014 nga Presidenti Afgan

dhe Përfaqësuesi i Lartë Civil i NATO-s në Afganistan, dhe më vonë u ratifikua nga Parlamenti Afganistan më 27 nëntor 2014. SOFA përcaktoi kërkesat dhe kushtet sipas të cilave forcat e NATO-s u vendosën në Afganistan si pjesë e Mbështetjes Rezolutive, si dhe aktivitetet që ato ishin caktuar për të kryer sipas kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja midis NATO-s dhe Afganistanit për krijimin e misionit të ri u mirëprit nga Rezoluta 2189 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. E miratuar njëzëri më 12 dhjetor 2014, ajo nënvizon rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme ndërkombëtare për stabilitetin e Afganistanit.

Në dhjetor 2015, në takimin e ministrave të Jashtëm të aleatëve të NATO-s dhe partnerëve të tyre RSM, u ra dakord të mbahet prania e RSM, përfshirë në rajonet e Afganistanit, gjatë vitit 2016. Gjashtë muaj më vonë, në maj 2016, ata ranë dakord të mbështetjen e RSM përtej vitit 2016 - një vendim që u konfirmua nga udhëheqësit aleatë në Samitin e NATO-s në Varshavë në korrik. Vitin tjetër, në një takim të ministrave të Mbrojtjes në nëntor 2017, vendet që kontribuan me trupat e RSM konfirmuan se numri i trupave të dislokuar do të rritet nga rreth 13,000 në rreth 16,000 trupa.

Negociatat paqësore ndër-afgane filluan në një ceremoni në Doha, më 12 shtator 2020. Aleatët e NATO-s do të vazhdojnë të mbështesin procesin e paqes

